

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2025/2026

(java e katërbëdhjetë, deri më 05.04.2026)


TË DHËNA JAVORE

Gjatë javës së katërbëdhjetë të vitit 2026 (nga 30.03-05.04.2026) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 110 ($I=6,0/100.000$) raste të të prekurve nga gripit/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 22,5% më pak se javën që shkoi (142).

Në javën e katërbëdhjetë të vitit të kaluar janë regjistruar 319 të sëmurë (rënie për 65,5%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (104) është regjistruar një rënie prej 5,8%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit gjatë javës së katërbëdhjetë është në kufirin e aktivitet jashtësezonal të virusit të gripit.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripit/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026




Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 64 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 24, tek grupmosha 5-14 vjet - 10 dhe tek grupmosha 0-4 vjet – 12 të sëmurë. Incidencë më e lartë (12,4/100.000) është regjistruar tek grupmosha 5-14 vjet.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 11 QSHP/NJR, pra në Shkup – 42, Prilep – 25, Ohër dhe Strumicë – nga 10, ndërsa në qytetet e tjera numri i të sëmurëve është nën 10. Në 20 qytetet nuk janë raportuar raste të të sëmurëve nga gripit.

Në 1 QSHP/NJR është regjistruar aktivitet sezonal, ndërsa në 10 është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit.

Hartogrami 1. *Niveli i aktivitetit të gripit dhe incidenca në 100.000 banorë, java e katërbëdhjetë, 2026*



Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së katërbëdhjetë të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 48 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga materialet e testuara 1 ka rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit - Influenza A e pasubtipizuar.

Është regjistruar 1 rast pozitiv me SARS-CoV-2.

Janë regjistruar edhe 2 raste pozitive me RSV.

МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - ТË DHËНА KUMULATIVE


Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripit/sëmundje të ngjashme me gripin është **16.722 (I=910,4/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=25.330) numri i rasteve të raportuara është zvogëluar për 34,0%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit (n=20.538) është regjistruar një rënie prej 18,6%.

Të sëmurë janë regjistruar në të gjitha QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve (n=5.479) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (I=2.681,4/100.000) në Dibër (n=513).

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 9.703 raste (58%), ndërsa incidencë më e lartë (2.022,4/100.000) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas QSH/NJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2025/2026



Shpërndarja e rasteve sipas muajve:

- tetor – 338 raste ose 2,0%
- nëntor – 438 raste ose 2,6%
- dhjetor – 1.324 raste ose 7,9%
- janar – 9.135 raste ose 55,7%
- shkurt – 4.336 raste ose 25,9%
- mars - 861 raste ose 5,1%
- prill (deri më 05.04.2026) – 110 raste ose 0,7%

Deri më tani janë regjistruar 4 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

МБИКËQYRJA VIROLOGJIKE – TË DHËNA KUMULATIVE

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 1.195 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Janë zbuluar 126 raste pozitive të gripit:


- **Influenza A – 120**
 - Influenza A(H1)pdm09 – 41 (32,5%)
 - Influenza A(H3) – 70 (56,6%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar – 15 (11,9%)

- **Influenza B – 0**

Janë regjistruar 26 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe 143 pozitive për RSV.

Janë detektuar edhe 5 viruse të tjerë respiratorë tek mostrat e testuara.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, RMV, 2025/2026



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Vazhdon rënia e numrit dhe incidencës të sëmundjeve të ngjashme me gripin në nivel javor. Gjatë javës së katërbëdhjetë është regjistruar aktivitet jashtësezonal i virusit të gripit në vendin tonë. Rezultatet e fituara nga mbikëqyrja virologjike tregojnë se ka një përhapje gjeografike sporadike të virusit të gripit. Përqindja e ratseve pozitive për katër javë me radhë është mbi 10%. Sipas të dhënave të pranuar në Maqedoni ka një intensitet të ulët të virusit të gripit.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi: <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtje nga gripin kanë për qëllim parandalimin e të gjitha sëmundjeve akute të frymëmarrjes dhe mund të jenë shumë të dobishme, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Evitoni grumbullimin dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, sidomos kontaktin e ngushtë me njerëz që janë të sëmurë ose që kolliten, teshtijnë, kanë temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose me dezinfektues.
- Ngrohni dhomat në të cilat qëndroni dhe ajrosini ato shpesh.
- Këshillohet të vishni rroba të ngrohta, në disa shtresa, të bëni banjo të ngrohta.
- Pini pije të nxehta (çajra dhe supa), lëngje frutash, ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira e të nevojshme për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limona, portokalle) janë veçanërisht të dobishme. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë të disponueshme, mund të përdoren edhe pije dhe preparate multivitaminike.
- Praktikoni një stil jetese dhe zakone të shëndetshme, duke përfshirë këtu gjumin dhe pushimin e mirë, të ushqyerit e shëndetshëm, ruajtjen e aktivitetit fizik dhe mendor dhe uljen e stresit.

Sistemi i fortë imunologjik do t'ju ndihmojë të qëndroni të shëndetshëm ose ta përballoni më lehtë gripin dhe sëmundjet e ngjashme me gripin. Megjithatë, edhe nëse jeni plotësisht të shëndetshëm dhe keni një sistem imunologjik të fortë, prapëseprapë mund të sëmurëni me grip ose një sëmundje të ngjashme me gripin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmurëni nga gripin?

Ndiqni këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë ose në vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë ndërsa jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një pecetë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidhni ato në plehra.
- Mbani maskë mbrojtëse kur kontaktoni me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagta që përmbajnë alkool ose dezinfektues për pastrimin e duarve.
- Shmangni prekjën e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën ku qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbajeni mjedisin tuaj të pastër - objekte, sipërfaqe, me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjet ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkoni ndihmë mjekësore.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritete të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.281 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vaksina falas.**

❖ 2.400 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vaksina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.841 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 79.122 persona me vaksina falas dhe vaksina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e dymbëdhjetë të vitit 2026:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 3 nga 26 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.
- Qarkullimi i virusit të gripit vazhdon të bjerë dhe tani është në nivele të ulëta deri të moderuara në të gjithë rajonin. Nëntipizimi tregon se nëntipet H1 dhe H3 të virusit të gripit A tani janë bashkë-dominuese, megjithëse ka ndryshime midis vendeve dhe zonave.
- Indikatorët rajonalë për SARS-CoV-2 kanë mbetur në nivele bazike.
- Indikatorët për RSV mbeten të lartë, por me tendencë drejt zvogëlimit të aktivitetit, me përjashtin të disa vendeve ku mbetet i lartë. Ngarkesa e sëmundjes dhe përqindja e rasteve pozitive mbeten më të larta tek fëmijët e moshës deri në 5 vjet.

OBSH i dha rekomandimet për vaksinat kundër gripit sezonal për përdorim në sezonin 2026-2027 në hemisferën veriore. Rekomandohet që vaksina trevalente të përmbajë:

Vaksina të bazuara në vezë

- A/Missouri/11/2025 (H1N1)pdm09-like virus;

- A/Darwin/1454/2025 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Tokyo/EIS13-175/2025 (B/Victoria lineage)-like virus.

Vaksina të bazuara në qeliza ose të rekombinuara

- A/Missouri/11/2025 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Darwin/1415/2025 (H3N2)-like virus; dhe
- B/Pennsylvania/14/2025 (B/Victoria lineage)-like virus.

Komponenta B/Yamagata lineage tashmë është hequr duke pasur parasysh se virusi nuk është regjistruar që në muajin mars.

*Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik*